

ÇËSHTJA KADANA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 50295/20)

VENDIM

STRASBURG

23 qershor 2026

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Kadana kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 50295/20) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë, më 9 nëntor 2020, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetas shqiptar, z. Izet Kadana (“kërkuesi”), lindur në vitin 1969 dhe i përfaqësuar nga z. A. Duraku, avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (“Qeveria”) e përfaqësuar z. O Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, në lidhje me ankesën, sipas nenit 6 të Konventës, që lidhet me çështjen nëse Kolegji i Posaçëm i Apelimit është “një gjykatë e krijuar me ligj” dhe për ta shpallur pjesën e mbetur të kërkesës të papranueshme;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 2 qershor 2026,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkarkimin e kërkuesit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”) dhe Dhoma e Posaçme e Apelimit (“KPA”) sipas Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar (shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuesi shërbeu si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë nga viti 1994 dhe si kryetar i saj nga viti 2016.

3. Më 20 dhjetor 2018, KPA-ja e shkarkoi kërkuesin nga detyra.

4. Më 1 shkurt 2019, kërkuesi apeloj kundër këtij vendimi në KPA-së.

5. Më 18 shkurt 2019, KPA-ja njoftoi kërkuesin për përbërjen e panelit të KPA-së, i cili përfshinte gjyqtarin L.D.

6. Më 10 janar 2020, kërkuesi paraqiti një kërkesë për përjashtim në KPA, sipas nenit 27 të Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar, duke kërkuar përjashtimin e L.D. nga paneli i KPA-së me arsyetimin se ai nuk i plotësonte kriteret e përshtatshmërisë për pozicionin e gjyqtarit të KPA-së. Kërkuesi vuri në dukje se më 24 dhjetor 1997 Këshilli i Lartë i Drejtësisë kishte marrë masën disiplinore të shkarkimit të L.D. nga detyra, një fakt të cilin L.D. e kishte fshehur gjatë intervistës së tij për pozicionin e anëtarit të KPA-së. Për më tepër, L.D. nuk kishte 15 vjet përvojë profesionale.

7. Më 17 janar 2020, ndërsa apeli i kërkuesit ishte në vazhdim para KPA-së, një kallëzim penal u ngrit kundër L.D. nga kërkuesi në një rast tjetër, z. Cani, një prokuror i cili ishte konfirmuar në pozicionin e tij nga KPK-ja dhe kundër konfirmimit të të cilit Komisioneri Publik

kishte paraqitur një apel i cili ishte ende në vazhdim para KPA-së (shih *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, §§ 35-39, 4 tetor 2022).

8. Më 22 janar 2020, KPA-ja e hodhi poshtë kërkesën e kërkuarit për të përjashtuar L.D. nga paneli. KPA-ja konstatoi se shkaqet për përjashtimin nuk lidheshin me paanshmërinë e L.D., por përkundrazi me mandatin dhe kompetencën e tij, çështje për të cilat KPA nuk kishte juridiksion të shprehur. Arsyet e përmendura nga kërkuari nuk e vinin në dyshim objektivitetin dhe paanshmërinë e L.D.-së, e as nuk përbënin shkelje të së drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt gjyqësor nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj.

9. Më 4 mars 2020, KPA-ja pranoi disa nga pretendimet e ngritura nga ankuesi në shkaqet e tij të ankimit, por, gjithashtu, konstatoi se ai nuk kishte kapacitet financiar, bazuar në vlerësimin e pasurisë së tij, dhe se sjellja e veprimet e tij kishin cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Për pasojë, KPA-ja e shkarkoi atë nga detyra. Ky vendim iu njoftua ankuesit më 24 korrik 2020.

10. Më 15 korrik 2020, prokuroria ngriti akuzë ndaj L.D. për falsifikim dokumentesh.

11. Më 24 korrik 2020, KPA-ja pezulloi L.D. nga detyra e gjyqtarit të KPA-së (shih *Besnik Cani*, cituar më lart, § 15).

12. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e shpalli L.D. fajtor për falsifikim dokumentesh dhe e dënoi me gjashtë muaj burgim, me kusht për një periudhë prej 12 muajsh.

13. Më 8 mars 2021, Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar la në fuqi vendimin e datës 1 dhjetor 2020.

14. Më 26 tetor 2021, Gjykata e Lartë e hodhi poshtë si të papranueshëm rekursin e paraqitur nga L.D.

15. Më 31 maj 2022, komisioni disiplinor i KPA-së shkarkoi L.D. nga detyra e gjyqtarit të KPA-së (*ibid.*, §§ 17-31).

16. Më 21 shtator 2023, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën kushtetuese të paraqitur nga L.D.

17. Kërkuari pretendoi, në bazë të nenit 6 të Konventës, se KPA-ja nuk ishte një “gjykatë e krijuar me ligj”, duke qenë se L.D. ishte emëruar në KPA në shkelje të kriterëve ligjorë të përshtatshmërisë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. FUSHËVEPRIMI I ÇËSHTJES

18. Në vërejtjet e tij të paraqitura në Gjykatë në vitin 2025, kërkuari komentoj mbi disa ankesa të cilat ishin shpallur të papranueshme nga kryetari i seksionit më 14 janar 2025. Ai, gjithashtu, ngriti ankesa të reja sipas Konventës, të cilat nuk janë një shtjellim i ankesës fillestare të komunikuar që kishte të bënte me aspektin, nëse KPA-ja ishte një gjykatë e krijuar me ligj. Këto ankesa nuk u paraqitën në Gjykatë në përputhje me rregullin 47 të Rregullores së Gjykatës dhe kriteret e pranueshmërisë, dhe për këtë arsye bien jashtë fushëveprimit të çështjes.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

19. Kërkuari u ankua se trupi gjyqësor i KPA-së, që e kishte shkarkuar nga detyra nuk përbënte një “gjykatë të krijuar me ligj”, pasi L.D. ishte emëruar në KPA në shkelje të kriterëve statutorë të pranueshmërisë.

A. Pranueshmëria

20. Qeveria parashtroi se pas dënimit penal përfundimtar dhe shkarkimit të L.D., kërkuari kishte pasur të drejtën të kërkonte një rishikim të vendimit përfundimtar të KPA-së, sipas nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Kërkuari nuk kishte përfituar nga ky mjet juridik dhe për këtë arsye ankesa e tij ishte e papranueshme, për shkak të mosshërimit të mjeteve juridike vendëse.

21. Qeveria deklaroi më tej, se KPA-ja e kishte shqyrtuar plotësisht kërkesën për përjashtim të kërkuarit dhe e kishte rrëzuar atë me arsyetimin se arsyet e përmendura nga kërkuari nuk e kishin vënë në dyshim objektivitetin dhe paanshmërinë e L.D. dhe për këtë arsye ankesa ishte qartësisht e pabazuar.

22. Kërkuesi deklaroi se ai kishte shteruar mjetet juridike vendëse, duke ngritur papranueshmërinë e L.D. para KPA-së.

23. Gjykata vëren se kërkuesi ngriti ankesën e tij në lidhje me moskualifikimin e L.D. gjatë procedurave të rivlerësimit kalimtar para KPA-së (shih *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, § 36 dhe §§ 66-73, 4 tetor 2022) sipas nenit 27 të Ligjit të Rivlerësimit Kalimtar, i cili ishte dispozita kryesore që rregullonte përjashtimin e gjyqtarëve të KPA-së. Në ankesën e tij, kërkuesi paraqiti qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme argumentin e tij se, në mungesë të një përjashtimi të tillë, paneli i KPA-së nuk do të konsiderohej një gjykatë e krijuar me ligj, për shkak të rrethanave të emërimit të L.D. Në rrethana të tilla, kërkuesit nuk i kërkohej që të fillonte procedurat për të shqyrtuar vendimin përfundimtar të KPA-së (shih, në të kundërt, *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, § 109-112, 13 dhjetor 2022, ku kërkuesja nuk përdori asnjë mjet juridik të brendshëm që synonte të garantonte të drejtën e saj që procedurat e saj të rivlerësimit kalimtar të përcaktoheshin nga një “gjykatë e krijuar me ligj”). Për rrjedhojë, Gjykata e rrëzon pretendimin e Qeverisë për mosshërim të mjeteve juridike.

24. Gjykata vëren se ky pretendim nuk është qartazi i pabazuar sipas interpretimit të nenit 35 3 (a) të Konventës dhe as nuk është i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

25. Kërkuesi mbajti pretendimet e tij.

26. Qeveria deklaroi se çështja duhej të dallohej nga çështja e *Besnik Canit* (e cituar më sipër) për arsyet e mëposhtme: L.D. kishte qenë anëtar i ligjshëm i panelit të KPA-së, kur ankesa e kërkuesit u shqyrtua nga KPA-ja; kërkesa e kërkuesit për skualifikimin e L.D. ishte shqyrtuar rregullisht nga një panel tjetër i KPA-së, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 27 të Ligjit të Rivlerësimit Kalimtar dhe ishte refuzuar; emërimi i L.D. në panelin e KPA-së nuk kishte ndikim në vendimin përfundimtar në lidhje me kërkuesin; dhe vendimi i KPA-së ishte bazuar në shqyrtimin e një vendimi të pafavorshëm që ishte marrë tashmë kundër kërkuesit.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Lidhur me efektin e shkarkimit të mëparshëm të L.D. nga detyra në emërimin e tij të mëvonshëm në KPA

27. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për një “gjykatë të krijuar me ligj” janë përmbledhur në *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* ([DHM], nr. 26374/18, §§ 218-34, 1 dhjetor 2020).

28. Gjykata ka shqyrtuar tashmë një ankesë në lidhje me emërimin e L.D. në KPA, pavarësisht shkarkimit të tij të mëparshëm nga detyra, në çështjen e *Besnik Canit* (cituar më sipër, §§ 94-116). Në atë rast, ajo vendosi se kishte pasur një pretendim të argumentueshëm për një shkelje të dukshme të një rregulli themelor të ligjit të brendshëm që kishte ndikuar negativisht në emërimin e L.D. si gjyqtar i KPA-së. Duke pasur parasysh, në veçanti, mosshqyrtimin e rregullt nga ana e gjykatave kombëtare të çështjeve përkatëse sipas Konventës të ngritura nga kërkuesi, Gjykata arriti në përfundimin në atë rast se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për shkak të faktit se L.D. ishte ulur në trupin gjykues të KPA-së, që kishte shqyrtuar çështjen e kërkuesit.

29. Pasi shqyrtoi të gjithë materialin e paraqitur, Gjykata nuk ka gjetur asnjë fakt ose argument që të mund ta bindë atë të arrijë në një përfundim të ndryshëm mbi themelin e ankesës konkrete. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për shkak të emërimit të L.D. në trupin gjykues të KPA-së, që shqyrtoi çështjen e kërkuesit.

b) Lidhur me pretendimin për mospërmbushje të kriterëve të tjera statutore të përshtatshmërisë nga L.D.

30. Duke pasur parasysh natyrën dhe fushëveprimin e shkeljes së gjetur sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj” (shih paragrafin 29 më sipër), Gjykata vendos se nuk ka nevojë të shqyrtojë këtë pjesë të ankesës.

31. Kërkuesi i kërkoi Gjykatës t'i caktojë dëmshpërblim financiar në shumën prej 20,188,014 lekësh, që korrespondonte me pagën e tij mujore, që mbulonte periudhën nga data e shkarkimit të tij deri në datën e paraqitjes së kërkesave të tij në Gjykatë. Në vijim, ai kërkoi 100,000 euro në lidhje me dëmin jopasuror.

32. Qeveria i kundërshtoi këto kërkesa.

33. Gjykata vëren se ka gjetur shkelje të së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, pa shprehur asnjë mendim mbi meritat e shkarkimit të kërkuesit. Gjykata nuk mund të spekulojë se cili do të kishte qenë rezultati i procedurave të verifikimit kundër kërkuesit nëse do të ishin përmbushur kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës dhe nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljes së gjetur dhe dëmit material të pretenduar; prandaj e hedh poshtë këtë pretendim.

34. Lidhur me dëmin jopasuror, Gjykata vlerëson se gjetja e një shkeljeje të nenit 6 § 1 të Konventës përbën shpërblim të drejtë të përshtatshëm për qëllimet e Konventës. Në një kontekst të ngjashëm, Gjykata ka treguar se rihapja e procedurave të rivlerësimit kalimtar do të ishte e përshtatshme (shih *Besnik Cani*, i cituar më sipër, § 149). KPK-ja e ka përfunduar mandatin e tij, dhe KPA-ja do ta përfundojë atë gjatë vitit 2026. Neni 179/b § 8 i Kushtetutës rregullon trajtimin e procedurave që janë pezull ose të pazgjidhura pas përfundimit të këtyre mandateve. Nëse kërkuesi e kërkon këtë, do të ishte e përshtatshme të rihapeshin procedurat dhe të rishqyrtohej çështja në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 6.

35. Kërkuesi nuk paraqiti asnjë kërkesë për kostot dhe shpenzimet. Rrjedhimisht, Gjykata nuk cakton asnjë shumë në lidhje me këtë pikë.

PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË UNANIME, GJYKATA:

1. *E shpall* të pranueshme ankesën bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës;
2. *Gjykon* se është shkelur parimi i sigurisë juridike sipas nenit 6 § 1 të Konventës, për sa i përket së drejtës së kërkuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”;
3. *Gjykon* se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pjesa e mbetur e ankesës bërë sipas nenit 6 § 1 të Konventës;
4. *Gjykon* se konstatimi i shkeljes në vetvete përbën shpërblim të drejtë për dëmin jopasuror të pësuar nga kërkuesi;
5. *Rrëzon* pjesën e mbetur të kërkesës së kërkuesit për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 23 qershor 2026, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE